KRONIKË E ZEZË

Arrestohet në Prishtinë një person për narkotik, gjatë kontrollit i gjenden edhe armë

24 prill 2023, 21:52

Shpërndaje në

Antidroga e Policisë së Kosovës ka arrestuar një person të shtunën në Prishtinë, si të dyshuar për posedim të narkotikëve.

I dyshuari fillimisht kishte tentuar të largohej, dhe kishte hedhur në tokë një qese të dyshuar me narkotikë.

Por, zyrtarët policorë pas pesë minutave ndjekje arritën ta kapnin, ndërsa gjatë kontrollit në trup i është gjetur edhe një armë.

Më pas të dyshuarit F.D. (2000) i është batisur edhe shtëpia ku i janë gjetur dy paketime me marihuanë, njëra me peshë 556 gramë e tjetra me peshë 568 gramë. Ndërsa po ashtu i është gjetur edhe një armë AK-47 me dy karikatorë.

I dyshuari është ndaluar për 48 orë.

"Pas një pune profesionale të hetuesve policor personi i dyshuar mashkull kosovar me iniciale (F.D; viti i lindjes 2000) është identifikuar dhe është takuar në rrugën "Beqë Lokaj", në Prishtinë, të cilin Policia e ka paralajmëruar të ndalet, por i njëjti ka hedhur në tokë një qese me substancë të dyshuar narkotike (me peshë prej 30 gramëve) dhe ka filluar të ikë duke vrapuar me shpejtësi. Policia ka vazhduar ndjekjen aktive të personit të dyshuar dhe brenda pesë minutave ka arrit ta ndaloj dhe arrestojë të njëjtin, ku pas kontrollit në trupin e tij është gjetur një pistoletë 7.65 mm, me një karikator me pesë (5) fishekë, (965) euro si dhe një telefon celular (Iphone 13 pro max). Në konsultim me organet e drejtësisë është bastisur- kontrolluar shtëpia e të dyshuarit në Prishtinë, nën dyshimin e bazuar në lidhje me veprën penale "Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike dhe psikotropike", vepër kjo e sanksionuar me kodin penal të RKS-së. Gjatë operacionit të bastisjes në shtëpinë e personit të dyshuar të lartcekur me iniciale në cilësi të provave materiale është gjetur dhe sekuestruar: një armë e gjatë AK-47 me një karikator dhe 2 fishekë, si dhe dy paketime me substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë me peshë: njëra prej 556 gramëve dhe tjetra qese prej 568 gramëve (në total marihuana e konfiskuar rezulton: 1 kg 154 gramë). Në konsultim me prokurorin kompetent, pas intervistimit i dyshuari ndalohet për 48 orë dhe rasti vazhdon të hetohet nga njësitet kompetente të antidrogës", thuhet në raportin e Policisë.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#POLICIA E KOSOVES #DROGA

Arrestohet serbi i dyshuar për të shtëna me armë, i konfiskohet AK-47-shi e 22 fishekë

Digjet një veturë në Fushë-Kosovë

I burgosuri në Dubravë rrah një të burgosur tjetër

Arrestohen për prostitucion një burrë e një grua në Gjilan

Policia në katër raste zë duhan të papërpunuar e cigare të kontrabanduara

Prokuroria nis hetimet ndaj ish-drejtorit ekzekutiv të Odës së Avokatëve

Gjobitet shoferi që tërhoqi me veturë dhinë e lidhur

Taboola Feed



Radio e Jashtme e Kinës
CRI ofron shërbime të pasura audiovizive për audiencën në mbarë botën
CRI | Sponsored

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë



Arrestohet babai që i dërgoi djalit substancë narkotike në burg
Policia e Kosovës ka njoftuar se ka arrestuar një burrë, i cili dyshohet se bashkë me rroba, i ka dërguar djalit të tij, në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës, edhe substancë të dyshu…
Kohanet

Qetësoni dhimbjen e kockave dhe të muskujve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

TË TJERA

Arrestohet babai që i dërgoi djalit substancë narkotike në burg

Një burrë në Prizren gjendet në shtëpi pa shenja jete, dyshohet se është vetëvrarë

Një grua në Ferizaj dyshohet se mbeti shtatzënë pas dhunimit nga disa persona

Aksident në Komoran, lëndohen dy persona

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.